




Republika e Kosovës
Republika Kosova–Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opstina Vitina – Municipality of Vitina



05-10-2012

01-013/1195

REGULLORE
PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME

Viti, Tetor 2012

Në mbështetje nenit 12.2 pika c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, të nenit 4.1 Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe nenit 35.2 pika a) të Statutit të Komunës së Vitisë o1.013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 03.10. 2012 aprovon këtë:

RREGULLORE

MBI TATIMIN NË PRONËN E PALUJTSHME PËR VITIN 2013.

Neni 1

1.1. Duke u bazuar në Nenin 6 Ligjit Nr. 03/L-204 Për tatimin në Pronën e Paluajtshme, dhe UA nr.04/2011, për caktimin e vlerës dhe standardeve të vlerësimit, baza tatimore në e komunën e Vitisë, do të caktohet si më poshtë:
Sipas Zonave tatimore në bazë të vlerës së tregut në m²

Destinimi i objektit	Zona IA	Zona IB	Zona IIA	Zona IIB	Zona III	Zona IV
Prona rezidenciale-shtëpi	300.00	240.00	220.00	200.00	150.00	100.00
Prona rezidenciale-banesë	400.00	380.00	360.00	340.00	/	/
Prona industriale	500.00	450.00	420.00	400.00	350.00	200.00
Prona komerciale	700.00	600.00	500.00	450.00	350.00	300.00
Prona bujqësore	120.00	100.00	90.00	80.00	60.00	40.00
Pronat e braktisura	160.00	140.00	130.00	120.00	120.00	100.00
Pronat e papërfunduara	120.00	96.00	90.00	80.00	60.00	40.00
Garazhet	120.00	103.00	90.00	80.00	50.00	30.00
Pishinat	200.00	170.00	160.00	150.00	140.00	135.00
Fushat sportive	150.00	120.00	110.00	100.00	90.00	85.00

Çmimet e trafave elektrike do të përcaktohen sipas fuqisë dalëse shprehur në kilovat dhe çmimeve të tregut.

Neni 2

2.1 Duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj, në Komunën e Vitisë, janë përcaktuar IV (katër) zona, dhe dy nënzona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 3

3.1. ZONA E PARË

QYTETI I VITISË – NËNZONA E PARË A (IA) QENDRA.

Përfshinë shtëpitë, lokalet dhe banesat në këto rrugë: "Adem Jashari", "Brigada 173", "28 Nëntori", "Rruga e Preshevës", "Rruga e Tiranës", "Hoxhë Jonuzi", "Dëshmorët e Vitisë", "11 Marsi" dhe "2 Korriku".

QYTETI I VITISË – NËNZONA E PARË B (IB). Përfshinë shtëpitë, lokalet dhe banesat në rrugët: "Dëshmorët e Kombit", "Lidhja e Prizrenit", "Agim Ramadani", "Kongresi i Manastirit", "Idriz Seferi", "Rruga e UÇK-së", edhe pronat që janë gjatë rrugës Viti-Kllokot, si vazhdim i rrugës së Preshevës (nga restorant

"Lindi"), si dhe shtëpitë dhe lokalet afariste që nuk janë në zonën IA, por gjinden më larg ose në rrugicat e paemëruara që prekin këto rrugë.

3.2. ZONA E DYTË

QYTETI I VITISË – NËNZONA E DYTË A (IIA) PERIFERIA DHE FSHATRA.

Përfshinë pronat në rrugët: "Flaka e Janarit", "Sherif Frangu", "Hafiz Ali Korça", "Hasan Prishtina", "Elena Gjika", "Rruga e Ulqinit", "Çerqiz Topulli", "Shota e Azem Galica", "Nora e Kelmendit", "Mustafë Koka", "Rruga e Shkupit", "Nikolla Tesla", "Isa Boletini", "Nëna Tereze", "Demokracia", "Hasan Kabashi", "Iliria", "Dimitrije Tucoviq" dhe "Milan Shuflla", si dhe shtëpitë dhe lokalet afariste që nuk janë në zonën IB, por gjinden më larg ose në rrugicat e paemëruara që prekin këto rrugë.

Si dhe shtëpitë dhe objektet afariste të fshatit Pozheran, Radivojcë, Ramjan dhe Budrikë që shtrihen përgjatë rrugës magjistrale Ferizaj-Gjilan. Gjithashtu pronat e fshatit Sodovinë e Jerlive, Drobesh dhe Gërmovë që shtrihen përgjatë rrugës magjistrale Viti-Gërllicë.

NËNZONA E DYTË B (IIB) PERIFERIA DHE FSHATRA.

Rrugë të tjera të qytetit, të paemëruara dhe prona të cilat lidhen me rrugët e lartpërmendura, por nuk ju takojnë këtyre emërtimeve, janë rrugë që lidhen me rrugët e nënzonës IIA.

Si dhe fshatrat katastrale: Pozheran, Budrikë, Sodovinë e Jerlive, Radivojcë, Ramjan, Drobesh, Gërmovë, Kabash, dhe Ramnishtë, duke përjashtua ato shtëpi dhe lokale afariste që bien në Nënzonën IIA.

3.3 ZONA E TRETË (III)

Përfshinë këto fshatra katastrale: Beguncë, Sllatina Epërme, Sllatina Poshtme, Smirë, Terpezë, Trestenik, Zhiti, Katuni i ri, Remnik, Gjylekar, Zhiti, Stublla e Epërme, Goshicë, Letnicë, Vërban, Binçë, Çifllak, Buzovik, Lubishtë, Podgorc, Sodovinë e Çerkezëve, Devajë dhe Ballancë.

3.4 ZONA E KATËRT (IV)

Përfshinë këto fshatra katastrale: Debellde, Mjak, Shashare, Vërnez, Vërnakollë, Goden i madh dhe Stublla e Poshtme.

Neni 4

4.1 Në pajtim me neni 7, të Ligjit Nr.03/L-204, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, të datës 01.11.2010 (Gazeta zyrtare e RK-së, nr-88/2010), normat tatimore për pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2013 për Komunën e Vitisë janë siç vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1.	Prona rezidenciale-shtëpi	0.15%
2.	Prona rezidenciale-banesë	0.15%
3.	Prona industriale	0.15%
4.	Prona komerciale	0.17%
5.	Prona bujqësore	0.15%

6.	Pronat e braktisura	0.15%
7.	Pronat e papërfunduara	0.15%
8.	Garazhet	0.15%
9.	Pishinat dhe Fushat sportive	0.17%

Neni 5

5.1. Pronat të cilat lirohen nga Tatimi në Pronë, e të cilat janë të cekura ne nenin 8 Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Vitisë

Neni 6

6.1. Të gjitha objektet e destinuar për komerciale të cilat nuk zhvillojnë afarizëm duhet të tatimohen me 70% të vlerës së tregut të objekteve komerciale, duke u thirrur në nenin 17 pika 1 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 7

7.1 Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 15 pika Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 8

8.1 Në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ 05/2011 neni 1, Kryetari i komunës së Vitisë emëron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin tatimor 2013.

Neni 9

9.1 Ligji Nr.03/L-204 "Për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë" dhe Udhëzimet Administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera, të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë, e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 10

10.1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në komunën e Vitisë, shfuqizohet Rregullorja nr.01-13/1770 e datës 05.10.2011.

10.2 Kjo rregullore hynë në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebib

